

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Tregjet dhe Institucionet Financiare
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla S1
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Mejdi Bektashi
Detajet kontaktuese:	mejdi.bektashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Lënda fokusohet kryesisht në rolin e tregjeve financiare dhe institucioneve financiare në funksionimin e jetës ekonomike. Ai synon t'u japë studentëve të kuptuarit për llojet e ndryshme të tregjeve dhe institucioneve financiare, instrumentet financiare, funksionimin e tregjeve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, bashkëveprimet ndërmjet pjesëmarrësve kryesor të tregut, mjedisin rregullativ dhe institucional në të cilin ata veprojnë.</p> <p>Kjo lëndë studion lloje të shumta të instrumenteve financiare, të tilla si aksione dhe obligacione, dhe instrumente moderne financiare të tilla si instrumentet derivative (opcionet, kontratat fjuçers, swaps kontratat etj). Lënda gjithashtu shtjellon forma të ndryshme të institucioneve financiare, ndërmjetësve financiarë (banka dhe jo-banka). Kursi elaboron edhe segmentet e tregut financiar, si tregun e parasë, kapitalit dhe tregun e valutës.</p> <p>Gjithashtu mbulon trajtime të veçanta në lidhje me konceptin e rrezikut, menaxhimit të rrezikut në institucionet financiare, kryesisht rreziku kreditor dhe i tregut.</p> <p>Lënda përpunon aspektet e ndryshme të analizimit të koncepteve, parimeve dhe teknikave të financimit bankar, financimit të ndërmjetësve të tjerë financiarë, tregjeve të parasë, tregjeve të kapitalit, tregjeve të valutës dhe tregjeve të derivateve. Kursi do të ofrojë analiza të praktikave aktuale të financimit të përdorura nga shumica e vendeve të zhvilluara të BE-së, vendet e rajonit dhe Republikës së Kosovës. Kursi elaboron edhe sisteme të tjera financiare të tregut të tilla si sistemi</p>

	<p>financiar islam, e sistemet të tjera financiare. Lënda ka për qëllim t'u japë studentëve një kuptim të rolit dhe rëndësisë së parasë, kapitalit, kreditisë, tregjeve dhe institucioneve financiare në një ekonomi moderne.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Qëllimi i lëndës është që të elaborojë nocionin dhe kuptimin e sistemit financiar, dhe që të ofrojë njohuri për studentët në lidhje me mekanizmat, strukturën dhe praktikën e aktiviteteve të sistemit financiar bashkëkohor, tregjet financiare, institucionet financiare dhe instrumentet e ndryshme financiare. Nga shtjellimi i këtyre nocioneve financiare studentët do të jenë në gjendje për të kuptuar teorinë, njohuritë themelore dhe teknikat e përdorura në sektorin bashkëkohor financiar, si dhe për të kuptuar ngjarjet e rëndësishme financiare, në një anë dhe marrjen e vendimeve të ndryshme financiare në anën tjetër.</p> <p>Objektivi i përgjithshëm i lëndës është t'u japë studentëve një kuptim të plotë të rolit qendror të institucioneve financiare në ekonomi, veçanërisht duke theksuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rolin e sistemit financiar në jetën ekonomike dhe shoqërore; • Rolin, rëndësinë dhe funksionin e tregjeve financiare të organizuara dhe institucioneve financiare në kohët e tashme moderne; • Funksionet, rëndësinë dhe misionet e institucioneve financiare si dhe tregjeve financiare, dhe • Ndryshimet strukturore dhe konkurrencën gjithnjë e më të theksuar në sektorët e ndryshëm financiar.
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p><i>Aftësitë dhe shkathtësitë që do t'i fitojnë studentët pas përfundimit të sukseshëm të kësaj lënde, është që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> •Të kuptojnë çështjet e rëndësishme aktuale në fushat kryesore të sistemit ekonomik financiar me qëllim që të njohin jetën reale ekonomik, pasi që gjithnjë e më shumë sistemi financiar po luan një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik; •Të fitojnë njohuri adekuate për të kuptuar rolin, rëndësinë dhe funksionin e tregjeve financiare të organizuara, institucioneve financiare dhe instrumenteve financiare; •Të fitojnë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar ndërvarësinë dhe ndërlidhjen në mes tregjeve

	<p>financiare, institucioneve financiare dhe instrumenteve financiare;</p> <ul style="list-style-type: none"> •Të kuptojnë çështjet e rëndësishme aktuale, duke marrë parasysh rolin e financimit dhe përmirësimeve në veprimet e sistemit financiar në procesin e përgjithshëm të rritjes ekonomike, modernizimit dhe zhvillimit ekonomik. •Të fitojnë njohuri adekuate për tregjet më të njohura të parave, kapitalit, letrave me vlerë, akcioneve e të tjera, dhe duke kuptuar se si tregjet e parave dhe kapitalit përdoren nga ana e investorëve institucionalë.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			143.5 orë

Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, ushtrimeve, seminareve, diskutimeve dhe konsultimeve. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë të inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre. Nga studentët paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literaturën relevante për temat e</i></p>
-------------------------------------	--

	<i>specifikuara të lëndës.</i>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 30%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi fina: 30%</p> <p>Total 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Frederic S. Mishkin & Stanley G. Wakins: Financial Markets and Institutions, Seventh edition, Prentice Hall, 2012 ose në shqip: <i>Tregjet dhe institucionet financiare</i>, Person, 2003 (libri është përkthyer në gjuhën shqipe); 2.Frederic S. Mishkin: Ekonomiksi i parasë, Bankingut dhe Tregjeve Financiare, Botimi i njëmbëdhjetë, Prishtinë 2018 3.Shelagh Heffernan: Modern Banking, John Wiley & Sons, Ltd, 2005 4.Roger LeRoy Miller, David D. VanHoose: <i>Paraja dhe bankat moderne</i> (botimi i tretë) 1993; 5.Alan S Blinder: Central Banking in Theory And Practice, MIT Press paperback edition, 1999 6.P.J. Hunt & J.E. Kennedy: Financial Derivatives in Theory and Practice: John Wiley & Sons, 2004 7.Kidwell. D. S.: <i>Institucionet financiare, tregjet dhe paratë</i>, Willey, N.Y. 2006; 8.Bernard J. Foley: <i>Tregjet kapitale</i>, Macmillan Education LTD London, 1991; 9.Frederic S. Mishkin: <i>Ekonomia e parave, bankave, dhe tregjeve financiare</i> botimi i 8, Pearson Education Inc. 2007; 10.Drini Salko&Orfea Dhuci: Paraja dhe Institucionet Financiare, Tiranë, 2005 11.Zamir Iqbal & Abbas Mirakhor: Hyrje në financat islame, teoria dhe praktika, John Wiley & Sons (Asia) Pte Ltd, 2007; 12. Alan Greenspan: <i>Epoka e trazirave, Avantura në një botë të re</i>, UETPres, Tiranë, 2012 13.Herbert B. Mayo: <i>Bazat e Financës, Hyrje në institucionet Financiare, Investime dhe Drejtim</i>, UETPres, Tiranë, 2012
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • David S. Kidwell, David W. Blackwell, David A. Whidbee, Richard L. Peterson: <i>Institucionet financiare, tregjet dhe paratë</i> • Stephen Cecchetti, Kemit Schoenholtz: <i>Paratë, bankat dhe tregjet financiare</i> • Linda Allen: <i>Tregjet kapitale dhe institucionet: një pikëpamje globale</i>

	Gazetat dhe materialet tjera www.qw.com/mishkineakins (student resources); www.federalreserve.gov www.forecasts.org/data/index.htm www.quicken.com www.nymex.com
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sistemi financiar; Teoria e strukturës financiare; Faktet parësore për strukturën financiare në botë; Financimi direkt dhe ndërmjetësimi financiar; Oferta dhe kërkesa në tregun financiar; rregullimi i sistemit financiar; institucionet rregullative dhe të mbikëqyrjes; Kostot transaksionale
Java e dytë:	Tregjet financiare- klasifikimi; Kuptimi dhe struktura e institucioneve financiare; Historia e tregjeve financiare; Qëllimi dhe rëndësia e tregjeve financiare; Pjesëmarrësit në tregjet financiare; Ndarja e tregjeve financiare; Banka Qendrore; karakteristikat dhe funksionet;
Java e tretë:	Tregjet e parasë; Tregjet e kapitalit; Tregjet devizore (valutore); dhe Tregjet e letrave me vlerë të derivuar; Tregjet financiare-klasifikimi; Blerësit dhe shitësit në tregjet financiare; Si funksionon tregu global financiar?; Tregjet tjera financiare; Agjentët pjesëmarrës në tregun financiar.
Java e katërt:	Tregjet financiare- klasifikimi; Tregu i kapitalit (obligacioneve); Tregu i aksioneve; Tregjet e derivative; Risku dhe Tregjet financiare; Risku dhe pasiguri; Menaxhimi me riskun në tregjet financiare; Strategjitë për parandalimin e riskut; Llojet e risqeve.
Java e pestë:	Ndërmjetësuesit financiar; Rëndësia e institucioneve financiare; Bankat dhe klasifikimi i tyre; Objektivat e bankave; Veprimtaria e depozitave dhe e kreditimit; Procesi i marrjes së kredisë bankare; Struktura dhe rregullimi i industrisë bankare.
Java e gjashtë:	Llojet e institucioneve financiare; Veprimtaritë kryesore të bankave; Llojet e fondeve investive sipas llojit të aktivës; Funkcionet e bankave tradicionale dhe atyre moderne; Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e strukturës në sektorin bankar;
Java e shtatë:	Karakteristikat organizative të modeleve të bankave bashkëkohore; Këshilli Qendror Kreditor–struktura; Këshilli Qendror Kreditor–detyrat; Këshilli për menaxhimin e aktivës dhe pasivës së bankës (ALCO); Sistemi pagesave; Linja e kreditimit dhe investimeve.
Java e tetë:	Karakteristikat e bankave bashkëkohore; Procesi i ndryshimit të formës dhe funksioneve të institucioneve financiare; Strategjia e ofrimit të shërbimeve bankare;
Java e nëntë:	Instrumentet Financiare; Roli dhe rëndësia e instrumenteve financiare; Llojet e instrumenteve financiare; Instrumentet monetare; Instrumentet derivative financiare; Letrat me vlerë.

Java e dhjetë:	Nocioni dhe rëndësia e aksioneve; Tregtimi me aksione dhe indeksi i aksioneve; Instrumentet e kapitalit aksionar; Aksionet e zakonshme dhe preferuara; Tregu devizor – valuator-valutat e huaja;
Java e njëmbëdhjetë:	Nocioni dhe rëndësia e Derivateve-Kontratave financiare; Llojet e derivative financiare; Përparësitë dhe të mangësitë e derivative; Kontratat fjuçers dhe kontratat opsion; Kontratat fjuçers të mallrave; Kontratat financiare fjuçers;
Java e dymbëdhjetë:	Indekset më të njohura të tregut, nga të cilat derivohen fjuçersat; Dallimet në mes forvardëve dhe fjuçersave; Karakteristikat e Fjuçersave; Karakteristikat e opcioneve; Karakteristikat e Hexhingut;
Java e trembëdhjetë:	Nocioni dhe rëndësia e obligacioneve; Llojet e obligacioneve; Reitingu i obligacioneve; Globalizimi dhe modernizimi i tregjeve financiare; Inovacionet financiare; Sekuritizimi.
Java e katërbëdhjetë:	Masat dhe legjislacioni antimonopolistik në sektorin financiar; Legjislacioni antimonopolistik; Legjislacioni antimonopolistik në BE dhe SHBA; Arsytet e paraqitjës së krizave financiare dhe instrumentet që më së shpeshti përdoren për tejkalimin e këtyre krizave.
Java e pesëmbëdhjetë:	Zhvillimi i sektorit financiar në Republikën e Kosovës, sukseset dhe problemet me të cilat ndeshet; Sektori Bankar, Sektori i sigurimeve; Sektori mikrofinanciar; Sektori pensional; Fondi Kosovar për Garanci Kreditore; Legjislacioni aktual që rregullonë sektorin Financiar; Banka Qendrore e Kosovës.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</i> • <i>Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</i> • <i>Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi;</i> • <i>Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.</i> <p>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kopjimi gjatë provimit ose testit;</i> • <i>Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;</i> • <i>Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;</i> • <i>Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.</i> 	